




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Planuar / Doretuar Planned / Provided Received / Delivered	26.04.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shloja Prilog Appendix	Sasia Kolicitimi Quantity
SKIMSICK	3855/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.491/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.491/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankues me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajit në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 26.04.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.491/2023 e datës 13.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-40/2023 i datës 13.02.2021 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Ferizajit dhe Njoftimi me numër 01-41/23 i datës 13.02.2023 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajit.

### A r s y e t i m

Komuna e Ferizajit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 14.11.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit "Specialistë të Shkencave Shoqërore" me numër të referencës RN00010421 lidhur me pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1" në Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Sektori i Bibliotekës, për klasën e pozitës Profesional 3.

Ankuesi me datën 17.12.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në fazën vlerësimit të testimit me shkrim dhe në fazën e vlerësimit

të jetëshkrimit pasi që Komisioni i Pranimit në Shërbimin Civil i Komunës së Ferizajit me datën 26.01.2023 publikon vlerësimin individual të kandidatëve për pozitën e punës "Zyrtar për Biblioteka 1", dhe me ç'rast ankuesi nuk kalon në fazat e mëtuqjeshme të konkursit me numër reference RN00010421.

I pa kënaqur me rezultatet e vlerësimit nga ana e komisionit të pranimit, me datën 09.02.2023, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit në Shërbimin Civil i Komunës së Ferizajit, me pretendimet ankimore kundër mos ftesës për intervistë me gojë dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa ky i fundit me datë 13.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-40/2023, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil të Komunës së Ferizajit lidhur me refuzimin e ankesës së tij, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokoll 2595/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajit, ndërsa me datën 18.04.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosijes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:2595/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit të Pranimit me Nr.01-40/2023 të datës 13.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 3076/2023 të datës 28.03.2023 të dërguar nga KPMSHCK për Komunën e Ferizajit; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 3618/2023 të datës 18.04.2023 të dërguar nga Komuna e Ferizajit për KPMSHCK; Shpalljen e Konkursit me numër reference RN00010421 të datës 14.11.2022; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00010421; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00010421; Vendimin e me Nr.01-219/22 të datës 15.12.2022; Njoftimin me Nr.01-38/23 të datës 08.02.2023; Njoftimin me Nr.01-41/2023 të datës 13.02.2023; Njoftimin me Nr.zyrtarisht të datës 20.03.2023; Ankesë e parashtruar nga ankuesi me datë 09.02.2023 drejtuar Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil të Komunës së Ferizajit; Lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet për aplikim në konkursin me numër reference RN00010421; Njoftim me 01.nr.zyrtarisht të datës 12.01.2023; Njoftim me 01.nr.zyrtarisht të datës 20.01.2023; Vendimin me numër 01-202/22 të datës 23.12.2022; Certifikatë mbi dënimet penale e lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës me datë 23.12.2022 për ankuesin; Vendim me numër 01-223/22 të datës 27.12.2022; Aplikacioni i kandidatit fitues i datës 13.12.2022 së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplomë me numër 046/2014 e lëshuar me datë 20.01.2015 nga Kolegji "HUMANISTICA"-Programi Shkenca Politike dhe Administratë për

; Diplomë me numër 5482 e lëshuar me datë 25.09.2017 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Departamenti i Filozofisë për . . . ; Marrëveshje për shërbime të veçanta në mes dhe Komunës së Ferizajit me nr. 03-99/2018 të datës 16.07.2018; Marrëveshje për shërbime të veçanta në mes dhe Komunës së ferizajit me nr.03-421/19 të datës 13.08.2019; Vërtetim me numër të protokollit 152 i lëshuar me datë 16.11.2022 nga Gjimnazi "Kuvendi i Arbrit" Ferizaj për . . . ; Kopje e ID-së e . . . ; Certifikatë me numër 9872 e lëshuar me datë 22.11.2022 nga Gjykata Themelore Ferizaj për . . . ; Ese Filozofike nga . . . ; Tetë rrëfime të botuara "Anomalitë e Shpirtit" nga . . . ; Libër "Inspektori" i botuar nga . . . ; Libër "Dekonstruksionisti" i botuar nga . . . ; Aplikacioni i kandidatit . . . i datës 17.12.2022 së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplomë me numër protokollit 206/19 e lëshuar me datë 05.06.2019 nga Gjimnazi "Kuvendi i Arbrit" Ferizaj; Kopje e ID-së e . . . ; Diplomë me numër 7827 e lëshuar me datë 25.07.2022 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Departamenti i Historisë; Katër Vlerësime individuale të biografisë së kandidatëve për vendin e punës i datës 26.01.2023; Akt emërim i kandidatit fitues . . . me . . . Nr.01-215/2023 i datës 20.03.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit . . . është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit "Specialistë të Shkencave Shoqërore", në Komunën e Ferizajit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00010421 lidhur me pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1" në Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Sektori i Bibliotekës, për klasën e pozitës Profesional 3, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS-apo ekuivalente me to, drejtimet Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të ngjajshme.*
- *Kualifikime të posaçme: Certifikata, Licenca kur kërkohen me lëgjislicionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1" në Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit-Sektori i Bibliotekës në Komunën e Ferizajit kanë aplikuar katërdhjetë e një (41) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë njëzetë e shtatë (27) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi . . . , tutje pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me shkrim dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesi nga ky proces i deritanishëm është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej gjithsejtë pesëdhjetë e gjashtë (56) pikë dhe se i njëjti është vlerësuar nga Komisioni i Pranimit në Shërbimin Civil i Komunës së Ferizajit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: " 1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi pas fazës së vlerësimit së testit me shkrim është vlerësuar me gjithsejtë katërdhjetë e tetë (48) pikë, më saktësisht në fazën e mëtutjeshme të vlerësimit të jetëshkrimit është vlerësuar më tetë (8) pikë, dhe si tillë Komisioni i Pranimi për Shërbimin Civil pranë Komunës së Ferizajit ka nxjerr vendimin me Nr.01-40/2023 të datës 13.02.2023 me të cilin ankuesi nuk mund të vazhdojë konkurimin në fazën e vlerësimit me gojë duke vepruar në pajtim me nenin 22 dhe konkretisht nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: *1.Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3.Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin përkatës që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 4.intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i Vlerësimit i cili përgatit apo zgjedh grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën me gojë të cilat përgaditen në ditën e zhvillimit të intervistës. 5. Vlerësimi maksimal për intervistën është deri në dhjetë (10) pike. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi, bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. Vlerësimi për çdo kandidat është mesatarja vlerësimeve të gjithë anëtarëve”.*


Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale dhe mos vërtetim të plotë të gjendjes faktike tek faza e vlerësimit të jetëshkrimit, pasi që i njëjti është vlerësuar me tetë (8) pikë, konkretisht për cilësinë dhe nivelin e arsimit e të cilat janë pikë maksimale pasi që i njëjti ka pasur notë të lartë mesatare gjatë studimeve Universitare konkretisht 9.61, mirëpo i njëjti në bazë të dokumentacioneve të lëndës nuk ka ofruar ndonjë provë relevante që mund të ndikojë në vlerësim ndryshe nga ai që i është bërë , andaj në mungesë të ndonjë prove relevante që mund të ndërlihet me vlerësim të jetëshkrimit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni i Pranimi në Shërbimin Civil pranë Komunës së Ferizajit, me vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit të lartë përmendur ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: *“1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda A.nr.491/2023, datë 26/04/2023.

Sabile Avdyli



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.